

URDHËR
Nr. 195, datë 25.5.2026

PËR MIRATIMIN E FORMATEVE STANDARDE PËR DOKUMENTIMIN E
VEPRIMTARISË SË INSPEKTIMIT NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenit 13, pika “a”, të ligjit nr. 99/2024, datë 12.9.2024, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”; të shkronjës “ç”, të pikës 5, kreu III, të vendimit nr. 330, datë 11.6.2025, të Këshillit të Ministrave, “Për organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit të Përgjithshëm”; si dhe urdhrit të Inspektorit të Përgjithshëm nr. 79, datë 31.3.2026, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Miratimin e formateve standarde për dokumentimin e veprimtarisë së inspektimit në Republikën e Shqipërisë, sipas formateve të aneksit që i bashkëlidhet këtij urdhri dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Formatet standarde për dokumentimin e veprimtarisë së inspektimit janë të detyrueshme për t’u zbatuar nga inspektoratet qendrore, inspektoratet vendore, trupat e inspektimit gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre të inspektimit.

3. Inspektoratet qendrore, inspektoratet vendore, trupat e inspektimit, në përputhje me veçoritë dhe kërkesat e legjislacionit të tyre specifik, të përshtatin formatet e tyre të dokumentimit të veprimtarisë së inspektimit, sipas fushave të inspektimit që mbulojnë.

4. Ngarkohen Inspektorati i Përgjithshëm, inspektoratet qendrore, inspektoratet vendore, trupat e inspektimit për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

INSPEKTOR I PËRGJITHSHËM
Dashnor Sula

ANEKS
DOKUMENTET E INSPEKTIMIT

Formatet standarde për dokumentimin e veprimtarisë së inspektimit në Republikën e Shqipërisë:

1. Autorizim inspektimi;
2. Listë verifikimi;
3. Procesverbal inspektimi;
4. Vendim përfundimtar i inspektimit;
5. Vendim i ndërmjetëm për marrjen e masës urgjente;
6. Vendim për zgjidhjen e ankimit të veçantë;
7. Kërkesë për refuzim të autorizimit të inspektimit;
8. Vendim për zëvendësim të inspektoratit në inspektim;
9. Kërkesë për shtyrje të autorizimit të inspektimit;
10. Vendim për shtyrje të autorizimit të inspektimit.